



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI KOMBETAR I UJIT
KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES "VJOSE", VLORE

VENDIM
Nr. 2, Dt. 11.06.2009

Per miratim leje, per shfrytezim inertesh ne shtratin e lumit Shushice, ne nje mjedis teresisht lumor, ne afersi te fshatit Drashovice (ne veri te tij)- Komuna Kote , Qarku Vlore, subjektit "SHUSHICA"sh.p.k. Vlore.

Ne zbatim te kerkesave qe percakton Ligji Nr.8093 Dt. 21/03/1996 "Per Rezervat Ujore", konkretisht, neni 8 dhe 20, vendimit nr. 1 dhe nr. 3, dt.21.06.2006, te K.K.U-se, si dhe vendimit nr.1 dhe nr.2 dt. 07.06.2007 te K.K.U-se, duke gjykuar mbi kerkesen dhe studimin e paraqitur nga subjekti "SHUSHICA" sh.p.k, Vlore, konform formularit "E", miratuar me vendimin nr.2, dt. 07.06.2007 te K.K.U-se, pasqyruar dhe ne relacionin shoqerues, paraqitur nga A.U.B "Vjose".

Keshilli i Basenit Ujembledhes "Vjose",

VENDOSI:

- 1- Te miratoj lejen, per shfrytezim inertesh ne shtratin e lumit Shushice, ne nje mjedis teresisht lumor, ne afersi te fshatit Drashovice (ne veri te tij, subjektit "SHUSHICA"sh.p.k. Vlore.
- 2- Siperfaqja e dhene ne shfrytezim (per 5 vjet) do te jete 0.147 km².
E kufizuar nga piketat, me koordinata si me poshte.

- Vazhdim i Vendimit Nr. 2, Dt. 11.06.2009

Nr Pikes	kordinata X	kordinata Y
1		
2	4 4 81 000	43 79 435
3	4 4 81 485	43 79 260
4	4 4 81 910	43 79 030
5	4 4 82 200	43 78 880
6	4 4 82 200	43 78 990
7	4 4 81 910	43 79 120
8	4 4 81 485	43 79 360
9	4 4 81 000	43 79 490
10		

3- Leja e shfrytezimit jepet per 5 vjet, me te drejte rinovimi çdo 3 vjet.

Koha e shfrytezimit te zones do te jete ajo e percaktuar ne vendimin nr.1, dt. 21.06.2006 te K.K.U-se, nga dt. 11.06.2009 duke u ricikluar çdo vit, deri me dt. 11.06.2012

4- Volumi i materialit qe do te merren per 3 vjet do te jete 60000 m³, me nje mesatare vjetore 20000 m³/vit, brenda zones qe jepet ne shfrytezim, thellesia e shfrytezimit deri ne 2 m, por jo me shume se 0.5m mbi pasqyren e ujrave fratike.

5- Ngarkohet A.U.B “Vjose” per zbatimin e ketij vendimi.

6- Ky vendim hyne ne fuqi menjehere.

PERGJEGJES I A.U.B-se “VJOSE”
Vezir METAJ



KRYETARI I K.B.U-se
HASAN HALILI

